



QENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

P.nr.1551/17

Më
Dana 13 - 02 - 2018 NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi si dhe procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në lëndën penale kundër të pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II nr.1449-1/15 të datës 08.06.2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Sebahate Sinani, të dëmtuarit [REDAKTUAR] si dhe të akuzuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me date 13.12.2017 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 21.12.2017 përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

Të akuzuarit:

1. [REDAKTUAR] i lindur me dt. [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], me vendbanim në [REDAKTUAR] ne [REDAKTUAR], ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
2. [REDAKTUAR] i lindur me dt. [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], me vendbanim në [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR], ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Se me datën 27.06.2015, rreth orës 21:30, në rrugën "Latif Hasani" në Ferizaj, përkatësisht afër Stacionit të Trenit, të pandehurit në bashkëkryerje me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, kanë marrë motoçikletën të tipit

“Mondial”, pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR], me te njëjtit me motoçikletën të vjedhur kanë shkaktuar aksident komunikacioni.

me të cilën kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje vjedhje nga neni 325 par.
1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 41, 46, dhe 73 e 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i

G J Y K O N

1. Të pandehurin [REDAKTUAR],

- DËNIM ME GJOBË, në shumë prej 200 Euro /dyqindë/, të cilin gjobë është i obliguar ta paguani në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

dhe

- DËNIM ME BURG, në kohëzgjatje prej 5 /pesc/ Muaj, i cilin dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda 1 /një/ Viti, nuk kryen vepër tjetër penale pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2. Të pandehurin [REDAKTUAR],

- DËNIM ME GJOBË, në shumë prej 200 € /dyqindë/, të cilin gjobë është i obliguar ta paguani në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

dhe

- DËNIM ME BURG, në kohëzgjatje prej 5 /pesë/ Muaj, i cilin dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda 1 /një/ Viti, nuk kryen vepër tjetër penale pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Në rast se të pandehurit nuk e paguajnë dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, konform nenit 46 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një /1/ ditë burgim.
- I dëmtuari [REDAKTUAR], me vendbanim në [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.
- Të pandehurit obligohen që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë solidarisht shumën prej 40 Euro /katëdhjetë/, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II nr.1449-1/15 të datës 08.06.2017, ka ngarkuar të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për veprën penale në bashkëkryerje vjedhje nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, më tutje prokurori i shtetit mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që të pandehuri të shpallen fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.12.2017, në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari [REDAKTUAR] është deklaruar*

fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza sipas të gjitha pikave, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, ndërsa në mendimin e tij mbi pranim të fajësisë shton se ndihet i penduar, kërkon falje publike të dëmtuarit, ka filluar të punon në një fabrikë të llaqeve dhe me nuk ka ra ndesh me ligjin, i premtun gjykatës se nuk do të përsërit vepra penale, andaj lut ti shqiptohet një dënim sa me i but.

I akuzuari [REDAKTUAR] është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza sipas të gjitha pikave të saj, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, kam gene me i ri dhe kam gabuar i premtun gjykatës se me nuk do të ndodhe, andaj kërkon gjykatën ti i shqiptoj një dënim sa me te but.

Prokurori i Shtetit Sebahate Sinani duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

I demtuari [REDAKTUAR] duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurve, deklaroi: ndjekjen penale i le të vendos gjykatës ndërsa demin e shkaktuar i cili sillet rreth 70 euro, kërkon ti kompozohet.

Pasi që të akuzuari kanë pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësore, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar, deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] e dt. 27.06.2015, deklaratat e te pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] te dt. 27.06.2015, raporti i oficerit nr. 2015-CF-1184 dt. 30.06.15, si dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lendes;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

- me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj trupi gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim fillestar publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim Se me datën 27.06.2015, rreth orës 21:30, në rrugën "Latif Hasani" ne Ferizaj, perkatesisht afer Stacionit te Trenit, te pandehurit ne bashkëkryerje me qëllim te përvetësimit te kundërligjshëm te pasurisë se luajtshme te tjetrit, kane marre motoçikletën te tipit "Mondial", prone e te dëmtuarit [REDAKTUAR], me te njëjtit me motoçikletën e vjedhur kane shkaktuar aksident komunikacioni.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale ne bashkëkryerje vjedhje nga neni 327 par. 1 lidhur me neni 31 të KPRK-së, të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysht të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata ndaj të akuzuarve si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori parasysht pranimin e fajësisë, rrethana lehtësuese i morri premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëritin vepra penale, moshën e re, gjendjen e dobët ekonomike, ndërsa në mungesë në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese Gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurve dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi baze të këtyre rrethanave i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysht edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i

shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohen te pandehurit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësore të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 40 € /katër dhjetë/, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.


Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P nr.1551/2017, me datë 21.12.2017

Zyrtare ligjore

Kadisha Shabani



Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.